

SYLË UKSHINI

NDËRHYRJA USHTARAKE E NATO-S NË KOSOVË: RAST PRECEDENT APO PËRJASHTIM?

Abstrakt:

Intervenimi ushtarak i NATO-s në luftën e Kosovës, përkatësisht goditja e caqeve ushtarake serbe, paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme në Evropë në dhjetëvjeçarin e parë pas përfundimit të konfliktit Lindje-Perëndim, që po ashtu çoi në dezintegrimin e dhunshëm të Federatës Jugosllave. Ishte kjo ndërhyrja e parë humanitare në historinë e NATO-s ndaj një shteti agresor, i cili deri në atë moment kishte refuzuar çdo zgjidhje me mjete paqësore dhe politike, refuzoi përmbushjen e të gjitha rezolutave të Këshillit të Sigurimit dhe Marrëveshjen e Rambujesë. Kjo ndërhyrje e NATO-s nuk ishte një luftë për interesa nacionale dhe as për pushtimin e territorit, por synonte të evitonte një “Bosnje të dytë” në Kosovë, e cila në këtë periudhë po përballlej me agresionin, vrasjet dhe dëbimet më masive që nga Lufta e Dytë Botërore.

Në këtë punim synohet për t'i dhënë përgjigje pyetjes hulumtuese: A ishte “ndërhyrja humanitare” e NATO-s në luftën e Kosovës një ndërhyrje legjitime dhe nëse ky intervenim përbënte një rast precedent apo përjashtim dhe përse intervenimi i NATO-s ishte i domosdoshëm në luftën e Kosovës? Së pari, është trajtuar çështja e “intervenimit humanitar” dhe principi i sovranitetit, përpara se të ndalemi në trajtimin e rrethanave të ndërhyrjeve humanitare në Kosovë. Kjo pasohet nga një përshkrim i shkurtër i situatës në Kosovë para ndërhyrjes dhe një pasqyrë e operacionit të Forcave Aleate. Në hapin e fundit, do të bëhet një analizë e motiveve dhe arsyeve të NATO-s, duke marrë parasysh mendimet e autorëve të ndryshëm që argumentojnë përmbushjen e kriterëve të kësaj ndërhyrjeje humanitare. Punimi im bazohet në burimet e botuara, në studime të autorëve të huaj, si dhe në shtypin e kohës, në të cilin trajtohet çështja e luftës së Kosovës dhe çështja e intervenimit ushtarak të NATO-s në kontekstin e ri ndërkombëtar pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Për të dhënë një sfond më të detajuar të ndërhyrjes ajrore të NATO-s në luftën e Kosovës, bëhet një vështrim përmbledhës rreth çështjes së “intervenimit humanitar” dhe principit të sovranitetit, konventave ndërkombëtare mbi konfliktet dhe luftërat, në mënyrë që

të përshkruaj rrethanat dhe rrjedhën e ndërhyrjes ajrore të NATO-s në periudhën 24 mars -10 qershor 1999. Në diskutimin publik ka dy pikëpamje të kundërta. Për disa ndërhyrja e 19 shteteve anëtare të NATO-s ishte një hap vendimtar larg një sistemi juridik ndërkombëtar të vjetërsuar, ndërsa për të tjerët mandatimi i Këshillit të Sigurimit ishte i nevojshëm për autorizimin e përdorimit të forcës nga NATO-ja kundër Jugosllavisë së mbetur.

Në fund të punimit paraqiten edhe konkluzionet përse rasti i Kosovës është një pikënisje e rëndësishme dhe një argument i qëndrueshëm, se përse shkëlja e të drejtave të njeriut nuk mund të përlligjet me argumentin e sovranitetit shtetëror. Ky intervenim i NATO-s njihet edhe si doktrina mbi ndërhyrjen humanitare, e cila prej rastit të Kosovës dëshmoi se sovraniteti shtetëror dhe integriteti i kufijve nuk janë kategori të shenjta në rendin juridik ndërkombëtar.

Fjalë kyçe:

Lufta e Kosovës, spastrimi etnik, vrasjet masive të popullsisë shqiptare, NATO, “intervenimi humanitar”, ShBA, BE-ja, Këshilli i Sigurimit, OKB, Serbia.

Hyrje

Historikisht, shtetet kanë filluar luftëra për të pushtuar territore, për të shënuar edhe rritje demografike, për të mbrojtur sovranitetin apo kredibilitetin e shtetit, për përfitime ekonomike apo politike. Por, reagimet në botë ndaj shkatërrimeve që sollën dy Luftërat Botërore të shekullit u dhanë fund të drejtave të disa shteteve për të luftuar, të drejta që i mbanin një kohë të gjatë. Karta e Kombeve të Bashkuara dënon publikisht përdorimin agresiv të forcës, si dhe implikimet e çfarëdolloj përdorimi të forcës nga shtetet për të arritur caqet politike. Në vend të kësaj, preferohet zgjidhja politike e paqësore e të gjitha mosmarrëveshjeve që rrezikojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Krijimi i Kombeve të Bashkuara më 1945 dhe procedimet e Tribunalit të Nyrbergut menjëherë pas kësaj, ishin ngjarjet kryesore. Këto, në mënyrë permanente, ndërruan natyrën dhe kushtet e debatet rreth të drejtës së shteteve që të bëjnë luftë dhe të trajtimin të qytetarëve të vet. Së bashku, këto i treguan botës se luftërat agresive nuk do të tolerohen më nga bashkësia ndërkombëtare, dhe se individët që bëjnë krime kundër paqes apo krime kundër njerëzimit, do të ndiqen penalisht për aktet e tyre.

Është e rëndësishme që të bëhet dallimi mes konflikteve të brendshme të armatosura dhe atij të jashtëm. Karta e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Gjenevës, Protokollet e tyre, si dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare rregullojnë¹ konfliktet e armatosura ndërkombëtare, mes shteteve. Në të vërtetë, Protokollet nga viti 1997 të Konventës së Gjenevës, në veçanti Protokoli II, përpiqen të rregullojnë konfliktet e brendshme të armatosura, pra ato që shfaqen brenda kufijve të një shteti. Por, të gjitha këto marrëveshje, përfshirë edhe protokollet nga viti 1977, ndalojnë palët nga jashtë, nënshkruese të traktit, që të intervenojnë në luftëra të brendshme apo civile. Me përjashtimet e kufizuara humanitare të Nenit 3 të Konventës së Gjenevës dhe Protokolleve të 1977-s, e drejta ndërkombëtare nuk e ndalon apo kufizon luftën civile.²

Mosintervenimi mbështetet mbi parimin e sovranitetit dhe në atë të vetëvendosjes, të cilat janë përgjithësisht të pranuar në të drejtën ndërkombëtare, por më vonë ky parim është përpunuar dhe sot shumë ekspertë të së drejtës ndërkombëtare mbështesin “intervenimin humanitar” me qëllim të mbrojtjes së njerëzimit.

Veçanërisht, “intervenimi humanitar” është çështja më e diskutueshme e së drejtës ndërkombëtare dhe e politikës ndërkombëtare që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë. Sidomos që prej intervenimit të NATO-s në rastin e luftës së Kosovës, që u zhvillua pa një mandat të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, diskutohet mbi atë se, në çfarë rrethana është i lejueshëm “intervenimi humanitar” sipas së drejtës ndërkombëtare dhe moralisht i përligjshëm, respektivisht i domosdoshëm. Është fakt se Karta e OKB-së nuk e precizon çështjen e “intervenimit humanitar”. Në lidhje me këtë, në qershor të vitit 1999 edhe ministri gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Sharping, theksonte: “Me Kombet e Bashkuara ekziston një problem fundamental, mund të thuhet edhe një dilemë. Ato paraqiten si bartëse të monopolit të dhunës, por ato nuk kanë mjete të dhunës. Dilema e dytë është mënyra e marrjes së vendimeve të Këshillit të Sigurimit. Kur u diskutua aty për Kosovën,

¹ Përpjekjet për ndalimin e përgjithshëm të luftës u kurorëzuan me lidhjen e Traktatit Brian-Kolleg, i cili ishte arritur me iniciativën e Francës dhe ShBA-së nga 15 shtete, më 27 gusht 1928. Traktati Brian-Kolleg ndalonte të gjitha luftërat agresive dhe në këtë pikëpamje përfaqësonte një hap të madh përpara në krahasim me Statutin e Lidhjes së Kombeve.

² Shih “Historia e sulmeve ajrore” (11), *Koha Ditore*, Prishtinë, 16 korrik 2002.

qëndrimin e NATO-s e kanë mbështetur 12 anëtarë nga 15 anëtarë sa ka Këshilli i Sigurimit. Kjo është më shumë se tri të katërtat. Por, kjo nuk do të thotë gjë për rregullat e KB-së. Ekziston edhe një dilemë e tretë parimore: kur të drejtat e njeriut dhe sovraniteti shtetëror bien në konflikt – si në rastin e Kosovës. Fatkeqësisht, për këtë ende nuk kemi një rregull të definuar.”³

Çështja e ndërhyrjes së NATO-s, një nga ngjarjet më të bujshme në periudhën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ka tërhequr vëmendjen e ekspertëve, studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare, të opinionit publik dhe të institucioneve e mekanizmave të ndryshëm, sikur intervenimet e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur, në mars të vitit 1999. Për këtë temë komplekse, vazhdon të ketë mendime dhe vlerësime kontraverse, para së gjithash në mesin e ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare, të cilët janë ndarë në dy kampe. Pozicionet nuk kanë ndryshuar në thelb që nga fillimi i debateve për Kosovën në vjeshtë të vitit 1998, kur filloi u zgjerua lufta në Kosovë midis UÇK-së dhe forcave ushtarake dhe policore serbe. Edhe pse secila palë ka provuar të konstatojë se zhvillimet e mëvonshme kanë konfirmuar pozicionet e tyre, çështja e intervenimit nuk ka marrë një përgjigje definitive nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare.

Shumica e rretheve politike, të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare dhe studiuesit e shkencave politike, përkrahin principin e vendimit për intervenimin ushtarak të NATO-s në favor të mbrojtjes së popullsisë shqiptare të Kosovës. Njëkohësisht ekzistojnë vështrime të ndryshme dhe kritike për disa aspekte të luftës, respektivisht për rrjedhën dhe rezultatin e saj.

Në mënyrë të vazhdueshme ekspertë të shumtë ndërkombëtarë janë marrë me aspektet më të rëndësishme të zhvillimeve në Kosovë dhe rajon, si dhe me çështjet kryesore të debatit publik për luftën e Kosovës, duke e trajtuar këtë nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kontekst, çështja e intervenimit të NATO-s në vitin 1999 nuk ka të bëjë vetëm me aspektet juridike, por prek edhe aspektet morale, të cilat kanë luajtur rol qendror në këtë ngjarje. Natyrisht, pikë kryesore e interpretimit mbetet çështja e vlerësimit juridik të “intervenimit humanitar”.

³ “Ran an Milosevics Vermögen”, *Die Woche*, Hamburg, 11 qershor 1999. f. 6-7.

Pa dyshim, rasti i “intervenimit humanitar” në Kosovë, që shënoi një fillim të ri në kontekstin e zhvillimeve të pas Luftës së Ftohtë, ka shtruar edhe nevojën e zgjerimit të Marrëveshjes së Gjenevës dhe revizionimin e principit të sovranitetit shtetëror. “Një baraspeshë e re midis parimeve të së drejtës ndërkombëtare, pra të sovranitetit shtetëror dhe të respektimit të të drejtave të njeriut, duhet të përpunohet. Konflikti rreth Kosovës, ndërhyrja kundër vrasjes së popullit dhe krimit më të rëndë kundër njerëzimit, le të shpresojmë se është gjithashtu fillimi i një procesi të tillë ndërkombëtar i të mësuarit”,⁴ konstaton ish ministri gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Scharping.

Para se të trajtohen aspektet e së drejtës ndërkombëtare të sulmeve ajrore kundër Jugosllavisë së mbetur, në mënyrë të përmbledhur do të japim një shpjegim për çështjen e “intervenimit humanitar” të NATO-s në krizën e Kosovës, si dhe rrjedhimet e këtij intervenimi në marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Ndërhyrja humanitare” dhe principi i sovranitetit

Nocioni i “ndërhyrjes humanitare”⁵ si në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare, ashtu edhe atë politik, nuk nënkupton çdo formë të

⁴ Rudolf Scharping: *Wir dürfen nicht wegsehen. Der Kosovo Krieg und Europa*, Berlin: Ullstein, 1999.

⁵ Ideja e “intervenimeve humanitare” është një fenomen relativisht i ri. Qysh para zhvillimit të këtij koncepti në të drejtën ndërkombëtare në shek. XIX në kontekst me Krizën Lindore, pati përligjeje të veprimeve klasike, çlirim të robërve të huaj nga sundimtarët tiranikë për shkak të shkeljes së të drejtave natyrore. Ky princip i intervenimit më pas mori formën e Kapitulacioneve, që u bënë midis shteteve evropiane të krishtera dhe Perandorisë Osmane. Kapitulacionet siguronin të drejtën që të përkujdesen për popullsinë e krishterë. Traktatet e para datojnë në vitin 1536 midis Perandorisë Osmane dhe Francës, pastaj mes Perandorisë Osmane dhe Anglisë (1580-83), përkatësisht Holandës (1684-1699) si dhe së fundi edhe me paqen e Karlovcit (1699). Pastaj intervenimi i Francës dhe i Anglisë në dy mbretëritë e Sicilisë (1856), intervenimi i Fuqive të Mëdha evropiane në Liban (1860). Një tjetër intervenim i rëndësishëm është ai i Fuqive të Mëdha evropiane në “krizën e madhe të Ballkanit” (1875-1878), respektivisht në Bosnjë e Hercegovinë me rastin e kryengritjes së fshatarëve të krishterë kundër sundimit osman. Po kështu, në kategorinë e ndërhyrjeve humanitare hyjnë një sërë intervenimesh gjatë viteve 90-të të shek. XX. Më gjerësisht, shih: Nasimi Aghayev, *Humanitäre Intervention und Völkerrecht – Der NATO-Einsatz im Kosovo*, Berlin: Verlag Dr. Köster, 2007; Thomas G. Weiss, *Humanitarian Intervention. Ideas in Action*, Cambridge u.a.: Polity Press, 2007; Mark Swatek-Evenstein, *Geschichte der “humanitären Intervention”*, Baden-Baden: Nomos, 2008.

ndërhyrjes së jashtme politike apo aksion të ndihmës humanitare në një territor të huaj, por masa, të cilat përfshijnë përdorimin e mjeteve ushtarake. Pra, bëhet fjalë për intervenim ushtarak. Pra, mjetet nuk janë humanitare, por qëllimet e intervenimit.⁶ Në të kaluarën në të drejtën ndërkombëtare, intervenimi klasik është përkufizuar në mënyrë eksplicite si përzierje e një shteti në punët e brendshme dhe të jashtme të një shteti tjetër, me qëllim që të ruhet ose ndërrohet gjendja ekzistuese.⁷ Por, që prej përfundimit të konfliktit Lindje-Perëndim në marrëdhëniet ndërkombëtare mund të vërehet tendenca që sovraniteti nacional (shtetëror) nuk mund të shërbejë më si mburojë për të mbuluar shkeljet sistematike e masive të të drejtave të njeriut dhe për të pamundësuar çfarëdo intervenimi të jashtëm.

Gjendja e rëndë e një popullsie brenda territorit të një shteti, mund të vlerësohet si kërcënim për paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare, në rast se ekziston mundësia që një situatë e tillë të ketë ndikim edhe jashtë shtetit.

Eksperti i së drejtës ndërkombëtare Aigul Taskushina, i cili në librin e tij *“Die humanitäre Intervention am Beispiel des NATO-Einsatzes im Kosovo”* merret ekskluzivisht me përligjjen e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, nocionin e “intervenimit humanitar” e përkufizon si vijon:

“Një intervenim humanitar - pavarësisht nga ligjshmëria e tij, nëse bëhet me përdorimin e forcës, nga ana e një apo më shumë shtetesh, apo nga ana e një organizate ndërkombëtare e cila është e pajisur me kompetencat përkatëse për përdorimin e forcës - është një ndërhyrje ndërshtetërore për të vendosur lirinë në një shtet tjetër, me qëllim që të ndikojë mbi këtë të fundit për të respektuar standardet minimale humanitare ndaj qytetarëve të vet.”⁸

Me çështjen e “ndërhyrjes humanitare” janë marrë autorë të ndryshëm qysh nga periudha e Mesjetës. I pari që u mor me këtë çështje

⁶ Krh: Hans-Richard Reuter, “Militärintervention aus humanitäre Gruenden? Friedensethik zwischen Gewaltverzicht und Rechtdursetzung”, në Berthold Mayer, *Eine Welt oder Chaos*, Frankfurt: Suhrkamp, 1996, f. 283.

⁷ Krh: Oppenheim-Lauterpacht, *International Law*, vol. Eight Edition, London: Longmans, Green & Co. 1955, f. 305. Cituar sipas: Zejnullah Gruda, “Intervenimi në të drejtën ndërkombëtare”, në *Përparimi*, nr. 1, Prishtinë: 1985, f. 91.

⁸ Aigul Taskushina, *Die humanitäre Intervention am Beispiel des NATO-Einsatzes im Kosovo*, Tectum Verlag Marburg: 2000, f.17.

ishte murgu dominikan Francisko de Vitoria (1493-1546), themelues i shkollës spanjolle të skolastikës së vonë në shek. XVI dhe XVII, më pas do të merren edhe teologu spanjoll Francisko Suarez (1548-1617) dhe themeluesi i së drejtës ndërkombëtare Hugo Grotiues (1583-1645), të cilët u morën me çështjen e intervenimit nga jashtë në funksion të mbrojtjes së shtetasve të huaj dhe çështjen e ekzistimit të kufijve të lirisë që kanë shtetet sipas së drejtës ndërkombëtare në raport me shtetasit e vet.⁹ “Intervenimi humanitar” respektivisht intervenimi ushtarak për qëllime humanitare, ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga shkelja e tyre sistematike dhe masive. Sipas këtij koncepti, të drejtat e njeriut kanë përparësi në raport me sovranitetin shtetëror¹⁰ dhe ky sovranitet nuk mund të përdoret si mburojë nga çdo ndërhyrje e jashtme. Pra, sovraniteti ka caqet e veta dhe se në periudhën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, nuk është më një koncept ekspansiv, por kufizues. Në këtë vështrim, shteti mbetet sovran vetëm për aq kohë sa nuk abuzohet me të. “Ta ngatërrosh “sovranitetin” me përdorimin dhe shpërdorimin e pakufizuar të pushtetit do të thotë t’ia mohosh sovranitetit burimin e vet, që është vullneti i popullit”, vlerëson Carlos Fuentes, duke shtuar se “sovraniteti është gjithashtu i vetëkufizuar në rrafshin ndërkombëtar në saje të parimit *sunt servanda*.”¹¹

Po kështu, edhe Këshilli i Sigurimit duke iu referuar kapitullit VII mund të autorizojë përdorimin e forcës ushtarake, në rast të kërcënimit të paqes si pasojë e shkeljes sistematike dhe masive të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Por, sipas Louis Henki-it, Richard C. Puugh, Oscar Schachter-it, Hans Smit-it (*International Law- Cases and*

⁹ Krh: Malte Wellhausen, *Humanitäre Intervention. Probleme der Anerkennung des Rechtsinstituts unter besonderer Berücksichtigung des Kosovo-Konflikts*, Baden-Baden: Nomos, 2002.

¹⁰ Sovraniteti shtetëror si kategori historike është problem relativisht i ri që lidhet me Paqen e Vestfalisë të vitit 1648, pas së cilës filloi edhe ndërtimi i modelit të shteteve kombëtare bazuar në parimin territorial. Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, kohët e fundit ka tendenca të mohohet ekzistimi i sovranitetit. Ai paraqitet si fenomen i së kaluarës, i cili ka humbur vlerën në ditët e sotme, me krijimin e organizatave ndërkombëtare. Të drejtën e sovranitetit e përmbajnë shumë dokumente të rëndësishme. Lidhja e Kombeve ka mbrojtur pavarësinë e anëtarëve të vet nga sulmi i jashtëm, kurse Karta e OKB-së ndalon çfarëdolloj kërcënimi me forcë, ose përdorimit të saj, i cili do të drejtohej kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të cilitdo shteti tjetër (Neni 2, paragrafi 4).

¹¹ Carlos Fuentes, “Kosova dhe rendi i ndërkombëtar”, në *Lufta kundër luftës*, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 75.

Materials) nuk është e thënë që intervenimi mund të ndërmerret vetëm në bazë të rezolutës së një organi të Kombeve të Bashkuara (Këshillit të Sigurimit), por mund të autorizohet edhe nga ndonjë organizatë regjionale.¹² Ky autorizim paraprak nga ndonjë organizatë ndërkombëtare universale ose regjionale, i jep legjitimitetin dhe intervenimin e dhunshëm e bën plotësisht me vend dhe të dëshirueshëm.¹³

Ndërsa, sipas kundërshtarëve të “intervenimit humanitar”, Këshilli i Sigurimit është i vetmi organ që ka të drejtë të autorizojë aksionin kolektiv në rast të paqes, ndërsa shkeljet serioze të të drejtave të njeriut, madje edhe gjenocidi nuk përbëjnë agresion ose rrezik a cenim të paqes ndërkombëtare nëse mbeten brenda kufijve shtetërorë.

“Intervenimi humanitar” ka funksionin e dënimit të shtetit që ushtron dhunë dhe kryen vrasje masive ndaj popujve apo pakicave kombëtare, gjë që i jep të drejtë shteteve të tjera të bashkohen për ta ndëshkuar dhe për ta pamundësuar realizimin e një qëllimi të tillë të dhunshëm.¹⁴ Ndërhyrjet humanitare janë një fenomen relativisht i ri në politikën ndërkombëtare. Shfaqja e tij mund të kuptohet vetëm nëse merret parasysh ndryshimi thelbësor i paradigmes së sistemit ndërkombëtar: ndarjen nga sistemi shtetëror i Vestfalisë, i cili u krijua në mesin e shek. XVII me Paqen e Vestfalisë.¹⁵ Ndryshimi i kësaj paradigme është rezultat i ndryshimeve në

¹² Cituar sipas: Zejullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Prishtinë: 2000, f. 100.

¹³ Burns H. Weston, Richard A. Falk, Hilary Charlesworth, *International Law and World Order*, Third Edition, West Group, St. Paul, Minn.: 1977 f. 290, cituar sipas Z. Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike ...*, f. 100.

¹⁴ Krh: Z. Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike...*, f. 99.

¹⁵ Paqja e Augsburgut e vitit 1655 dhe Traktati i Vestfalisë në vitin 1648 shërbejnë si referenca të rëndësishme kur diskutohet për çështjen e sovranitetit. Këto dy traktate, që shënojnë linjat e demarkacionit në luftërat religjioze të Reformacionit, kanë etabluar sistemin bazë ndërkombëtar që ekziston deri më sot. Guri themeltar i këtij sistemi ishte sovraniteti i sunduesit dhe i shtetit. Sipas këtij parimi, kurrfarë fuqie nuk mund të detyrojë një shtet sovran që të ndërmarrë çfarëdo aksionesh që nuk dëshiron t'i ndërmarrë përbrenda kufijve të vet territorialë. Nëse nuk ekziston një gjendje lufte, asnjë shtet apo shtete të tjera nuk kanë autoritet legal që t'i dërgojnë forcat e tyre të armatosura përtej kufijve të tyre ndërkombëtarë, përveç nëse nuk ftohen ta bëjnë këtë. Shih: “*The Peace of Westphalia*”. University of Oregon. Retrieved 6 October 2021, <https://pages.uoregon.edu/dluebke/301ModernEurope/Treaty%20of%20Westphalia%20%5BExcerpts%5D.pdf>; “How did the Peace of Augsburg (1555) lead to the Thirty Years War 1618-1648”, [https://dailyhistory.org/How_did_the_Peace_of_Augsburg_\(1555\)_lead_to_the_Thirty_Years_War_\(1618-1648\)](https://dailyhistory.org/How_did_the_Peace_of_Augsburg_(1555)_lead_to_the_Thirty_Years_War_(1618-1648))

nivel global në fillim të viteve '90, të cilat rezultuan me përmbyshjen e sistemeve komuniste në Evropën Lindore dhe Juglindore, përkatësisht me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë shumëkombëshe.

Por, duhet përmendur se janë të njohura ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha evropiane në shek. XIX në “krizën e madhe të Ballkanit” (1875-1878), me rastin e kryengritjes së fshatarëve të krishterë kundër sundimit osman në Bosnjë. Me këtë rast, Prusia, Perandoria Osmane dhe Rusia përmes të ashtuquajturit Memorandum i Berlinit ofruan një armëpushim të afatizuar.¹⁶

“Intervenimet humanitare” do të ndodhin edhe në shtete dhe rajone të tjera të botës në fillim të viteve '70 në Pakistanin Lindor (1971), Kamboxhia (1978-79), Uganda (1978-1979) dhe në Afrikën Qendrore (1979). Krahas këtyre ndërhyrjeve, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë në kategorinë e “intervenimeve humanitare” hyjnë mbikëqyrja ajrore e Irakut Verior nga forcat multinacionale (1990) për mbrojtjen e kurdëve dhe shiitëve, më pas intervenimi në Somali, Kamboxhia, Runda (1994-1995), në Bosnjë-Hercegovinë (1995) dhe së fundi në Kosovë dhe Timorin Lindor (1999). Natyrisht, këtu bën përjashtim intervenimi në Afganistan, si rrjedhim i sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 dhe në Irak për përmbyshjen e regjimit të Sadam Huseinit, megjithëse ekzistojnë ngjashmëri midis këtyre dy luftërave dhe “intervenimit humanitar”. Veç kësaj, lufta e Kosovës ndryshon në shumë pikëpamje edhe me luftën në Gji, para së gjithash, për shkak të gjeografisë dhe rrethanave. Lufta e Kosovës shpeshherë është vlerësuar si luftë “evropiane”, ngase ka ndodhur në tokën evropiane. Po kështu, është lufta e parë që Aleanca Transatlantike ka zhvilluar së bashku dhe pa mandat të OKB-së.

Nevoja për t'i ndjekur ligjërisht ata që kanë shkelur të drejtat e njeriut dhe ligjet ndërkombëtare është më e fortë sesa sovraniteti shtetëror. Shtetet nuk mund të mbyllen në kornizën e sovranitetit dhe paprekshmërisë së tyre të brendshme, pasi të drejtat dhe liritë e njeriut tani janë çështje universale dhe relativizojnë dukshëm sovranitetin klasik shtetëror të tipit të Vestfalisë.¹⁷ Vënia në qendër të vëmendjes e të drejtave njerëzore bie ndesh me pikëpamjet tradicionale, që janë të rrënjosura mirë edhe në kampin konservator. Bota e sotme ka një

¹⁶ Krh: M. Wellhausen: *Humanitäre Intervention ...*, f. 69-70.

¹⁷ Krh: Blerim Reka, *Kushtetuta e UE-së: Rubikoni i Supranacionales*, Shkup: Logos-A, 2007, f. 53.

ndjeshmëri të re, nuk toleron që të shtypen të dobëtit, nuk toleron gjenocidin, torturën, përdhunimet etnike. Në kohën kur po ndodhte sulmi i NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur në fillim të muajit prill: sekretari i atëhershëm i OKB-së nënvizonte, në mes të veprimit ushtarak në Kosovë, se lufta kundër shtypjes së shqiptarëve të Kosovës tashmë duhet të mbizotërojë mbi shqetësimet për sovranitetin, dhe shtonte se kjo gjë - në mënyrë të shkallëzuar, por të sigurt - tashmë po kthehet në një “normë ndërkombëtare.”¹⁸

Sidoqoftë, për dallim nga të gjitha zhvillimet e tjera ndërkombëtare, intervenimi i NATO-s në Kosovë deri më tani ka qenë pika kulmore e zhvillimit të “intervenimit humanitar” respektivisht kulmimi i një numri ndërhyrjesh të kryera në emër të të drejtave të njeriut dhe vlerave njerëzore,²⁰ megjithëse hamendja e vendeve evropiane e vononte këtë intervenim të NATO-s në luftën e Kosovës. Në këtë linjë është e drejtë paralelja që bën ish ministri i Jashtëm izraelit, nobelisti për Paqe, Shimon Peres, kur thotë se “Hebrenjtë akuzuan Perëndimin që nuk ndërhyri menjëherë kundër nazizmit dhe tani Perëndimi vendosi të ndërhyjë në Kosovë para se të ishte tepër vonë. Mund të jemi dakord ose jo me tipin e operacioneve ushtarake, por nuk mund të mohohet se objektivi i tyre është i një natyre morale.”²¹

Pra, pas përfundimit të periudhës së bipolaritetit ka ndryshuar në mënyrë të qartë vlerësimi i së drejtës ndërkombëtare për ndërhyrjen në çështjet e brendshme të një shteti, në rast të shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare. “Asnjë shtet nuk ka të drejtë që të fshihet prapa sovranitetit shtetëror për të shkelur të drejtat e njeriut apo të drejtat fundamentale të popullit të vet”, kishte thënë sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan, gjatë një fjalimi para Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë në prill të vitit 1999.²²

Megjithatë, edhe më tej interpretimi i së drejtës ndërkombëtare lidhur me “intervenimin humanitar” në rastin e Kosovës nuk është unik.

¹⁸ Massimo D’Alema, *Kosova: Italianët dhe lufta* (intervistë e gazetarit Federico Rampini), Tiranë: Uegen, 2004, f. 100.

²⁰ Henry Kissinger: *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme?, Drejt një diplomacie për shekullin e njëzetë e një*, Tiranë: Plejad, 2005, f. 387.

²¹ Shimon Peres, “Ç’mendojmë ne, nobelistët e paqes”, në *Lufta kundër luftës*, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 218.

²² Shih: R. Scharping, *Wir dürfen nicht wegsehen ...*, f. 106.

Përligjja e ndërhyrjes së NATO-s në luftën e Kosovës

Sipas principeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara vetëm Këshilli i Sigurimit është kompetent për marrjen e masave ushtarake kundër një shteti. Sidoqoftë, operacioni i NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur nuk pati një vendim të Kombeve të Bashkuara, ngase Rusia nuk e miratonte një intervenim ushtarak. Shumë ekspertë të së drejtës ndërkombëtare kanë mendime të ndryshme nëse ky operacion i NATO-s ka qenë legjitim apo në kundërshtim me nenin 2, paragrafin 4 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që ndalon përdorimin e dhunës dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare kishte bërë një sulm ajror kundër Jugosllavisë së mbetur.

Duke u nisur nga nevoja morale dhe politike për të penguar përsëritjen e një “Bosnje të dytë”, “ndërhyrja humanitare” në Kosovë u bë i domosdoshëm dhe legjitim, por, njëkohësisht këtë ndërhyrje e karakterizoi ambivalenca. Në njërin anë, udhëheqësit e vendeve të NATO-s nuk dëshironin të përsëritej Bosnja, në anën tjetër, preokupimet humanitare kishin të bënin me një vend që ata e konsideronin si pjesë të Jugosllavisë së mbetur. Prandaj, me të drejtë ka vlerësuar ish Sekretari amerikan i Shtetit, Henri Kissinger (Henry Kissinger) se “në fakt, ata ishin të qartë se çfarë kërkonin të parandalonin, sesa çfarë kërkonin të arrinin dhe si kërkonin ta arrinin.”²³

Të dyja vendimet, pro dhe kundër intervenimit, kishin rrjedhime me konsekuenca ndërkombëtare: e para, po të mos intervenonte bashkësia ndërkombëtare, ekzistonte mundësia që numri i vrasjeve dhe i dëbimeve të merrte përmasa tragjike, si në rastin e Bosnjës. Për më tepër, sjellja e Beogradit zyrtar në dhjetë vitet e fundit kishte treguar se pa një kërcënim të fuqishëm ushtarak, nuk lëshon pe. Po kështu, zhvillimet e deriatëhershme në Kosovë, masakrat në Prekaz, Rogovë dhe Reçak, por edhe zbulimi i mëvonshëm i planit “Patkoi” dëshmojnë se udhëheqja serbe ishte përgatitur të shkonte deri në fund, të dëbonte në masë shqiptarët nga Kosova. Me këtë, Perëndimit i kërcënohej edhe një valë e refugjatëve, ndërsa vendeve të rajonit të Evropës Juglindore dhe më gjerë, destabilizimi politik.

Parë në aspektin politik dhe ndërkombëtar, ishte fjala, po të lejohej që konflikti etnik dhe ushtarak të zgjerohej dhe Milosheviqi të vazhdonte

²³ H. Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme ...*, f. 408.

me politikën e tij represive kundër shqiptarëve, atëherë me këtë do të cenoheshin edhe principet fundamentale të të drejtave të njeriut. Njëkohësisht do të vihej në lojë kredibiliteti i bashkësisë ndërkombëtare, respektivisht i NATO-s, e cila edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë mbetej e vetmja organizatë e rëndësishme e sigurisë në Evropë. Mosveprimi i Aleancës Veriatlantike për t'u marrë me problemin e Kosovës do ta bënte të dukej atë joefektive si Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë së BE-së dhe si OKB-ja. Veç kësaj, NATO-ja ndodhej nën presionin e veprimit pas kërcënimeve ushtarake që i ishin bërë atij nga ministrat e Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s, në rast se Milosheviqi nuk do të lëshonte pe dhe nuk do të tregohej i gatshëm për një zgjidhje diplomatike.

E dyta, intervenimi ushtarak kundër Jugosllavisë së mbetur, që ishte shtet i pranuar ndërkombëtarisht, pa një mandat paraprak të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kundërshtohej nga përkrahësit e konceptit tradicional shtetëror në të drejtën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Përkrahësit e kësaj linje mbronin qëndrimin se një ndërhyrje pa mandat e Këshillit të Sigurimit e kthente në situatën e para krijimit të Lidhjes së Kombeve, kur një shtet apo shumë shtete e merrnin vetë legjitimitetin për të ndërhyrë ushtarakisht kundër një shteti apo shumë shteteve. Pra, parë në interpretimin klasik të së drejtës ndërkombëtare, sulmet e NATO-s kundër Jugosllavisë ishin ilegale. Ky vlerësim²⁵ mbështetet në parimin klasik të sovranitetit, i cili nënkupton pushtetin e plotë mbi territorin e tij dhe pavarësinë e shtetit prej cilitdo shteti tjetër në marrëdhëniet ndërkombëtare. Por, kjo do të rrëzonte besueshmërinë në shtetet perëndimore si dhe besimin në të drejtën e bashkësisë ndërkombëtare, në kohën kur KS i OKB-së, që ishte “përgjegjës kryesor për ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare”, vazhdonte të mbahej i paralizuar nga kërcënimi i Rusisë dhe i Kinës për përdorimin e vetos kundër çdo nisme për ndëshkim ushtarak të Jugosllavisë së mbetur.

²⁵ Parimi i mosintervenimit është shpallur për herë të parë nga Revolucioni borgjez Francez, ndërsa si politikë zyrtare e një shteti është proklamuar nga Presidenti i ShBA-ve, James Monro, më 2 dhjetor 1823. Në të drejtën ndërkombëtare deri me përfundimin e sistemit të bipolaritetit, intervenimi është ndaluar pa marrë parasysh motivet, pasi ato në të shumtën e herëve përdoreshin për ruajtjen e baraspeshave politike.

Më pas, kur edhe Gjermania e Franca, si partnere të rëndësishme të amerikanëve e britanikëve, lëshuan pe, në mars të vitit 1999 të gjitha shtetet anëtare të NATO-s duke përfshirë edhe Turqinë dhe Greqinë u deklaruan të gatshme për të përkrahur ndërhyrjen e NATO-s në krizën e Kosovës. Po kështu, gati të gjitha shtetet në rajon përkrahën intervenimin e NATO-s me karakter humanitar. Edhe bota arabe mbështeti NATO-n. Ndërsa vendet latino-amerikane “Grupi Rio” dhe vendet e Lëvizjes së të Painkuadruarëve, në mesin e tyre India dhe Afrika Jugore i kundërshtuan sulmet ajrore si cenim të Kartës së OKB-së. Po kështu, kundër intervenimit të NATO-s u deklaruan qartë edhe Rusia, Ukraina, Bjellorusia, Kina, Namibia si dhe kundërshtarët tradicionalë të ShBA-së, Iraku, Irani, Libia, Kuba dhe Vietnami,²⁶ me justifikimin se kjo gjë kishte ndodhur pa mandatin e Këshillit të Sigurimit. Por, eksperti gjerman në Universitetin e Hamburgut, Valter Reese-Shefer (Walter Reese-Schäfer), thekson se, në rastin e Kosovës nuk mund të pritej që OKB-ja të legjitimonte këtë luftë, sepse “Këshilli i Sigurimit ishte i bllokuar nga Kina dhe Rusia”.²⁷

Por, mosveprimi i Këshillit të Sigurimit në një situatë jashtë-zakonisht urgjente, dëshmoi se reformimi i këtij institucioni ishte i domosdoshëm, parë sidomos në dritën e zhvillimeve të reja ndërkombëtare të pas Luftës së Ftohtë. Norbero Bobio në esenë e tij “Luftë e të drejtave”, thotë: “Është e vërtetë, e kam thënë edhe herë të tjerë, që kjo luftë nuk është plotësisht legjitime, që është jashtë rregullave të Kartës së OKB-së, por është gjithashtu e vërtetë që sot e drejta ndërkombëtare po institucionalizohet, siç ka pohuar në esenë e tij Jürgen Habermas, që po kryhet një institucionalizim progresiv i saj. Ajo nuk i lihet më marrëdhënies ndërkombëtare të forcës mes shteteve; kanë nisur të vendosen disa rregulla: gjykata ndërkombëtare për krimet e luftës, normat kundër gjenocidit. Ka tashmë disa gjykatës që, në bazë të këtyre rregullave japin sentenca që e kapërcejnë pushtetin e shteteve të veçanta.”²⁸

²⁶ Shih: M. Wellhausen: *Humanitäre Intervention ...*, f. 220-221.

²⁷ Intervistë me profesorin e shkencave politike në Universitetin e Hamburgut, Walter Reese-Schäfer, në *Kosovapress*, Xhevat Ukshini, 16.06.1999, “Lufta e shqiptarëve të Kosovës është e drejtë”.

²⁸ Norbero Bobio, “Luftë e të drejtave”, në *Lufta kundër luftës*, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 66.

Derisa shtetet ishin unike për angazhimin e tyre me karakter humanitar, mbizotëronte dilema për bazën ligjore. Që në fillim, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe e vlerësuan të lejueshëm përdorimin e forcës, për shkak të rrezikut të një “katastrofe humanitare” dhe mundësisë e ndikimit të saj në stabilitetin e rajonit të Ballkanit. Presidenti amerikan Bill Clinton në fjalimin e tij mbajtur gjatë vizitës së trupave amerikane në Shkup, më 21 qershor 1999, deklaroi: “Ne, mund t’u themi njerëzve në botë, kudo që jetoni, në Afrikë, në Evropën Qendrore, apo kudo tjetër, në rast se dikush përndjek qytetarë të pafajshëm dhe përpiqet t’i vrasë në masë, për shkak të racës, përkatësisë etnike, apo besimit të tyre, e nëse kjo është në fuqinë tonë për ta ndalur, ne do ta ndalojmë.”²⁹

Afirmimi i doktrinës së ndërhyrjes humanitare shprehet qartë sidomos në suksesin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në luftën e Kosovës. Menjëherë pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, më 10 qershor 1999, Kryeministri i atëhershëm britanik Toni Bler shpalli misionin e Kosovës si një fitore “progresive” në politikën e jashtme, duke zëvendësuar konceptet e vjetruara tradicionale: “Kjo luftë u zhvillua për një parim themelor të nevojshëm për përparim të njerëzimit: që çdo qenie njerëzore, pavarësisht nga raca, feja apo lindja gëzon një të drejtë të patjetërsueshme për të jetuar i lirë nga persekutimi.”³⁰

Ndërhyrjen ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur e kishte parë si të domosdoshme edhe kancelari i atëhershëm i Gjermanisë, Gerhard Schröder, i cili përgjegjësinë për këtë konfrontim të Perëndimit me qeverinë e Milosheviqit e adreson te politika e tij agresive, tek ideja për vazhdimin e brutalitetit dhe terrorit sistematik kundër popullsisë shqiptare në Kosovë dhe synimit për cenimin e sigurisë rajonale. Në deklaratën e qeverisë federale gjermane, kancelari Schröder deklaronte se NATO dhe vendet anëtare po luftojnë në Kosovë për të drejtat e njeriut, për liri dhe për demokraci, duke shtuar se qëllim i këtij angazhimi mbetet se si duhet të duket Evropa në shek. XXI, pas dy përvojave tragjike që përjetoi bota në shek. XX. “Ne dëshirojmë që sa më shpejt t’i japim fund katastrofës humanitare dhe shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut. Ne dëshirojmë të arrijmë një zgjidhje politike për Kosovën”, theksonte

²⁹ Presidenti Bill Clinton, fjalim për forcat e KFOR-it, Shkup, 22 qershor 1999.

³⁰ Kryeministri Toni Bler, fjalim pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë, Londër, 10 qershor 1999.

Shröder.³¹ Për nevojën e intervenimit të NATO-s në Kosovë ishte treguar aktiv qysh në mesin e vitit 1998 edhe Volker Röhe, ministër i Mbrojtjes në qeverinë gjermane të kancelarit Helmut Kohl. Ai këmbëngulte për një rol të pavarur të NATO-s nga KB-ja, derisa ministri i Jashtëm Klau Kinkel dhe vetë kancelari Kohl tregoheshim më të rezervuar dhe shpreheshin për nevojën e një mandati paraprak nga Këshilli i Sigurimit të KB-së. Ndërsa në shtator të vitit 1998, vetëm pak ditë pas ardhjes në pushtet të koalicionit të majtë kuq-gjelbër, qeveria federale gjermane mbështeste tashmë hapur intervenimin ushtarak pa mandat të KB-së.³² Derisa ministri i Mbrojtjes Röhe këtë pozicion e kishte përfaqësuar edhe në takimin e ministrave të Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s në qershor 1998.

Ndërkaq, ish Kryeministri italian, Masimo D'Alema theksonte motivin etik dhe idealin për një rend ndërkombëtar të themeluar mbi të drejtat e njeriut, që si vlerë tejkalonte edhe sovranitetin kombëtar. "Ishte një luftë e re, që nuk kishte shpërthyer nga qëllimet territoriale ose nga vullneti i forcës. Ne nuk donim që të pushtonim Ballkanin, por që të afirmonim një ideal të një rendi ndërkombëtar të themeluar mbi të drejtat e njeriut, mbi lirinë dhe tolerancën. Një vlerë kaq e fortë sa kapërcente madje edhe sovranitetin kombëtar."³³

Me një fjalë, angazhimi i Perëndimit në luftën e Kosovës nuk kishte për qëllim pushtimin e territoreve as interesa gjeopolitike, por afirmimin e një ideali të një rendi ndërkombëtar të themeluar mbi të drejtat e njeriut. Një vlerë që kalonte madje edhe sovranitetin shtetëror.

Debatet pro dhe kundër legjitimitetit të intervenimit të NATO-s në Kosovë

Në fund të shek. XX opinioni publik botëror pa edhe një luftë tjetër në Ballkan midis shqiptarëve dhe serbëve, e cila ndodhi për shkak të politikës shtypëse dhe kolonialiste të Beogradit, që synonte me çdo mjet realizimin e doktrinës së vjetër për spastrimin etnik të Kosovës dhe krijimit të Serbisë së Madhe. Diplomati amerikan Uoren Zimmerman thotë

³¹ *Erklärung Bundeskanzler Gerhard Schröder zur Lage im Kosovo*, Bonn, 24.04.1999. Burimi: Pressemitteilung Nr. 111/99 vom 24. März 1999; Internet: <http://www.bundesregierung.de>

³² "Röhe droht Serben mit der NATO", *Süddeutsche Zeitung* (SZ), München, 17.9.1998.

³³ M. D'Alema, *Kosova: Italianët dhe lufta ...*, f. 98.

se serbët dëshironin ta kishin gjithë Kosovën të veten dhe, për këtë, plani i Milosheviqit ishte realizimi i depërtimit më të madh të dhunshëm të popullit pas Luftës së Dytë Botërore.³⁴ Në fund, njësitet ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe detyruan mijëra shqiptarë të largohen nga shtëpitë e tyre, ndërkohë bisedimet për paqe të Rambujesë, përkatësisht Parisit, kishin dështuar për shkak të refuzimit të Beogradit për të pranuar një marrëveshje për zgjidhjen kalimtare të problemit të Kosovës. Në këtë situatë, komuniteti ndërkombëtar nuk pa ndonjë alternativë tjetër për të provuar të pengojë vuajtjen e mëtejme njerëzore, shtypjen dhe dhunën kundër popullsisë civile shqiptare, përveç përdorimit të forcës ushtarake. Më 24 mars 1994, NATO-ja ndërmori “intervenimin humanitar” për t’i dhënë fund dëbimit si dhe katastrofës humanitare në Kosovë. Pas dhjetë javë sulmesh ajrore të Aleancës Perëndimore dhe katër javë përpjekjesh diplomatike, Milosheviqi dhe Parlamenti Serb më 3 qershor 1999 pranuan planin paqësor të G-8, të cilin Beogradit ia kishte dorëzuar emisari i BE-së, Marti Ahtisari.³⁵ Fundi i luftës mbërriti më 11 qershor, aq papritur saqë shumë pakkush e priste.

Mbi ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në luftën e Kosovës pa mandatin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, janë shkruar shumë studime shkencore dhe janë bërë interpretime të ndryshme. Pyetja kryesore ka qenë dhe vazhdon të jetë kjo: A kishte të drejtë NATO-ja të ndërhynte ushtarakisht pa mandatin e Kombeve të Bashkuara në konfliktin etniko-politik brenda një shteti sovran, edhe pse qëllimi ishte humanitar dhe synonte t’i jepte fund spastrimit etnik? Pra, shtrohej pyetja sa ishte i përligjur ky veprim ushtarak edhe atëherë kur OKB, për shkak të mekanizmave të trashëguar nga e kaluara nuk ishte në gjendje të pengonte shkeljen masovike të të drejtave të shqiptarëve, madje edhe atëherë kur po i kërcënohej depërtimi në masë. Në radhë të parë, çështja e ligjshmërisë së “ndërhyrjes humanitare” mbetet me rëndësi dhe aktualitet në politikë dhe në të drejtën ndërkombëtare.

Dr. Yoram Dienstein, ekspert i së drejtës ndërkombëtare dhe anëtar i Institutit Max Planck në Heidelberg (Gjermani), në një shkrim të tij të vonshëm kritik ndaj intervenimit të NATO-s në Kosovë, thoshte: “Askund në Konventën (për gjenocid) nuk thuhet se ekziston zgjidhja e

³⁴ Uoren Zimerman, “Diplomacia e pushkës së zbrazët”, (3), *Zëri*, Prishtinë, 23 dhjetor 2002.

³⁵ Sylë Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi*, Prishtinë: Rilindja, 2001, f. 285.

tretë për një fushatë ajrore unilaterale.” Por cili është justifikimi legal, *jus ad bellum*, për intervenimin ajror të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur, në mars të vitit 1999. Udhëheqësit dhe ekspertët e NATO-s artikuluan në mënyrë shumë bindëse çështjen e intervenimit në luftën e Kosovës, duke iu referuar vetëmbrojtjes kolektive dhe sigurisë rajonale sipas neneve 51, 52 dhe 53 të Kartës së Kombeve të Bashkuara të OKB-së. Thënë ndryshe, vendet anëtare në NATO kishin parashikuar një riparaqitje të ngjarjeve që ishin parë vite më parë në Bosnjë e Hercegovinë.

Disa vende anëtare të NATO-s vlerësuan se intervenimi ishte i arsyeshëm bazuar në motivet humanitare, duke përmendur planet e Milosheviqit për të “pastruar etnikisht Kosovën.” Ndërsa, autori i njohur i librit “Përse kombet shkojnë në luftë” (Why Nations Go to War), Johan G. Stoessinger, mendon se “katalizatori që përshpejtoi fillimin e fushatës së bombardimeve ajrore nga NATO-ja, ishte i dyfishtë. Së pari, zbulimi i një numri masakrash të forcave serbe kundër shqiptarëve, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, e shtynë NATO-n të merrte vendim. Së dyti, Fuqitë Perëndimore zbuluan planin e përgjithshëm strategjik të Milosheviqit për të “zgjidhur” problemin shqiptar, i njohur si operacioni “Patkoi”. Në përputhje me emrin e koduar të tij, Milosheviqi planifikonte t’i mbyllte shqiptarët brenda një patkoi gjigant dhe pastaj t’i detyronte ata të iknin nga Kosova. Shkatërrimi i pasurisë së tyre dhe të gjitha dokumenteve të identifikimit do të garantonin që ata të mos ktheheshin dot kurrë. Me një fjalë, Kosova do të “spastrohej” nga myslimanët me qëllim që të sigurohej “lebensraum” për ardhacakët serbë”.³⁶

Një mbështetës i zëshëm i intervenimit të NATO-s në Kosovë ishte edhe Presidenti çek, Václav Havel, vendi i të cilit ishte bërë anëtar i ri i NATO-s vetëm dymbëdhjetë ditë para se aeroplanët e NATO-s të nisnin sulmet ajrore kundër caqeve ushtarake kundër Jugosllavisë, me qëllim që t’i jepnin fund fushatës së tmerrit dhe të spastrimit etnik të shqiptarëve të Kosovës. Në një deklaratë mbi situatën në Kosovë, në Pragë, më 28 janar 1999, Václav Havel-i theksonte se duhet të jetë e qartë për Beogradin se e vetmja alternativë ndaj bisedimeve është përdorimi i forcës nga Aleanca e Atlantikut. Megjithatë, ai nuk u gëzua, duke i quajtur operacionet një “zgjidhje ekstreme”, dhe shprehte mbështetjen e tij të patundur për

³⁶ John G. Stoessinger, *Përse kombet shkojnë në luftë*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë: 2015, f. 176-184.

aksionin, që sipas tij, ishte “krejtësisht i pashmangshëm”. Ashtu si gjithmonë, kur përballej me një vendim të vështirë, ai më 24 mars 1999, me rastin e intervenimit ushtarak të NATO-s në luftën e Kosovës, i drejtohej një parimi të thjeshtë moral: “Përvoja jonë historike na ka mësuar se e keqja nuk duhet zbutur, por duhet kundërshtuar.”³⁷

Për Kosovën, më shumë sesa për Bosnjën apo Gjirin përpara saj, një vend i vogël, i parëndësishëm dhe pa ndonjë rëndësi të dukshme strategjike apo ekonomike për Perëndimin, kjo ndërhyrje i hapte rrugën doktrinës për intervenim humanitar, një aksion ushtarak, qëllimi i vetëm i të cilit ishte të pengonte vrasjen e civilëve të pafajshëm. Václav Havel-i shihet me të drejtë si një nga baballarët ideologjikë të kësaj doktrine, krahas figurës së Madeleine Alnright, e lindur në Çeki dhe e traumatizuar në mënyrë të ngjashme nga Marrëveshja e Mynihut (München).³⁸

“Mbështetja e patundur nga Haveli i ndërhyrjes në ish Jugosllavi dhe në Kosovë, madje edhe mbështetja e tij e mëvonshme ndaj përpjekjeve për rrëzimin e Sadam Hyseinit pati një çmim, i cili e “njollosoi” figurën e tij të idealizuar si një mbrojtës i shenjtë i mospërdorimit të dhunës. Por, këtu bëhet fjalë më shumë për figurën se sa për njeriun: Haveli, ashtu si Gandi dhe Mandela, po mbronte mospërdorimin e dhunës jo vetëm si një çështje e parimeve morale, por edhe si një armë e luftës politike. Haveli do t’i jepte gjithmonë përparësi rrugës paqësore dhe miqësore të zgjidhjes së konfliktit, por ai besonte fuqimisht në papranueshmërinë e zbutjes, ku përballeshe me të keqen, për të qenë pacifist”³⁹, shkruan Michael Zantovsky, në librin e tij për Havel-in.

Autori i njohur latino-amerikan Mario Vargas Losa, në një shkrim të tij për luftën e Kosovës, vlerëson se ndërhyrja e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur ishte e vonuar për dhjetë vjet, prandaj ajo duhej qortuar jo për ndërhyrjen, por për vonesën e saj, e cila pati pasoja të rënda për Kosovën, ndodhën krimet më të rënda kundër njerëzimit. Kjo vonesë ndezi “dritën e gjelbër të diktaturës së Beogradit për të vënë në jetë planin për spastrimin etnik të Kosovës, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer përgjatë këtij shekulli, i krahasuar për nga natyra, edhe pse jo për nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të realizuar nga Hitleri ose me depërtimin e popujve prej

³⁷ Deklaratë e Presidentit të Republikës mbi ndërhyrjen ushtarake në Jugosllavi, Pragë, 24 mars 1999, cituar sipas Michael Zantovsky, *Haveli*, AIIS, Tiranë: 2018, f. 459.

³⁸ *Po aty*, f. 507-508.

³⁹ *Po aty*, f. 459.

Stalinit, i cili ishte i vendosur në synimin e vet për të rusifikuar Bashkimin Sovjetik.”⁴⁰

Lufta e Kosovës dhe intervenimi i NATO-s në mars të vitit 1999 shkaktoi një debat intensiv të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare, intelektualëve dhe politikanëve, debat ky që u karakterizua me pozicione shumë kontraverse. Teoria e përlligjes ligjore përkrah aksionin e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur edhe nëse ai nuk ishte në tërësi sipas kritereve të së drejtës ndërkombëtare, por megjithatë legjitim përkritazi me shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe në raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën⁴¹ të botuar në tetor të vitit 2000, nxirren dy përfundime kryesore: njëri ishte se ndërhyrja e NATO-s në luftën e Kosovës, përkatësisht kundër Jugosllavisë së mbetur nuk ishte legal, por ishte legjitim. Ishte jolegal sepse u bë pa mandatin paraprak të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në njërën anë, dhe ishte legjitim sepse në Kosovë ndodhnin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut; sepse të gjitha mundësitë diplomatike ishin të shterura; sepse Kosova u çlirua dhe të gjithë ata që ishin dëbuar nga forcat serbe ishin në gjendje të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre.⁴²

Intelektuali i njohur francez Adre Glucksman, gjatë një debati për Kosovën në shtëpinë *Heinrich Böll*, të organizuar më 4 korrik 1999, është shprehur në mënyrë kritike ndaj pikëpamjeve të autorëve të së drejtës ndërkombëtare, të cilët sulmin ajror të NATO-s kundër një vendi sovran e cilësojnë joligjor, ndërsa asnjë fjalë nuk thonë për masakrat e shpërnguljet në Kosovë.⁴³

Aigul Taskushina⁴⁴, thekson se, nëse vjen deri te një situatë konflikti të armatosur, të organizuar dhe të vazhdueshëm midis qeverisë së një shteti dhe kryengritësve, atëherë janë të zbatueshme principet e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Sipas Taskushinës, intervenimi në rastin e

⁴⁰ Mario Vargas Llosa, “Një luftë e vonuar”, në *Lufta kundër luftës*, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 13.

⁴¹ Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën është rezultat i nismës së Kryeministrit suedez, zotit Göran Persson. Komisioni është i pavarur nga qeveria e Suedisë si dhe nga cilado qeveri a institucion tjetër, qoftë kombëtar apo ndërkombëtar. Shih: *Pse pavarësi e kushtëzuar, Komisioni i pavarur ndërkombëtar për Kosovën*, KIPRED, Prishtinë: 2005.

⁴² Krh: *Po aty*, f. 1.

⁴³ Krh: Ismail Kadare, *Ra ky mort e u pamë. Ditar për Kosovën, artikuj, letra*, Tiranë: Onufri, 2000, f. 157-159.

⁴⁴ Shih: A. Taskushina, *Die humanitäre Intervention am Beispiel des NATO....*, f.33.

Kosovës ishte legjitim. I të njëjtit mendim është edhe Reinhard Merkel,⁴⁵ i cili thekson se “intervenimi humanitar” në Kosovë në mars të vitit 1999 ka pasur fundament legjitim të së drejtës ndërkombëtare.

Ndërkaq, eksperti tjetër i së drejtës ndërkombëtare, profesor në Universitetin e Göttingenit, Georg Nolte, sulmet e NATO-s i shikon si cenim i qartë i Kartës së KB-së, neni 2, numër 4, e cila ndalon përdorimin e dhunës. Karta në fjalë parashikon dy përjashtime, por asnjëra nga ato nuk vlejnë për këtë rast. Nuk ka ekzistuar një vendim i Këshillit të Sigurimit që në Kosovë të intervenohet ushtarakisht dhe, të drejtën për vetëmbrojtje ia jep vetëm shteteve të pavarura. Këtë nuk e kontestojnë edhe dy ekspertët e së drejtës ndërkombëtare, Kristian Tomushalt dhe Karl Doehring. Por, të dy argumentojnë se çështja e ligjshmërisë së luftës nuk mund të gjykohet vetëm në bazë të kartës së KB-së. Parë në dritën e rëndësisë së të drejtave të njeriut, në rrethanat e reja të së drejtës ndërkombëtare, sulmet e NATO-s ishin të ligjshme. Këtu Doehring mbështetet në motivet ligjore të ndihmës emergjente. Principi që kujtdo, që sulmohet në mënyrë të kundërligjshme nga tjetri, t’i ofrohet ndihmë, në ditët tona duhet të vlejë edhe në rastet e gjenocidit apo të krimeve kundër njerëzimit - edhe nëse këtë, karta e KB-së nuk e parashikon qartë.⁴⁶

“Sovraniteti shtetëror dhe ndalimi i intervenimit nuk mund të përdoret në mënyrë absolute”, thekson Tomuschat. Sipas tij, të drejtat e njeriut do të duhej të kishin përparësi në raste të kërcënimeve të mëdha. Por, Tomuschat, ashtu si edhe Doehring, thekson qartë se Këshilli i Sigurimit ka përparësi, sa kohë që ai përmbush përgjegjësinë e vet.

Përveç kësaj, përkrahësit e intervenimit të NATO-s u thirrën në shumë vendime të Këshillit të Sigurimit, në të cilat ky forum kishte formuluar se shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut në kuadrin e një shteti mund të paraqesë “rrezik për paqen”. Sikundër dihet, para fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s, Këshilli i Sigurimit në Rezolutën e tij për Kosovën vinte në dukje se aktet e dhunës serbe kundër shqiptarëve të Kosovës konsiderohen si kërcënim për paqen. Pra, është e qartë se kritikët e sulmeve ajrore të NATO-s më shumë kanë dëshirë t’i mbrojnë pozicionet e tyre politike dhe ideologjike, sesa të mbrojnë të drejtat

⁴⁵ Shih: Reinhard Merkel (Hrsg.), *Der Kosovo-Krieg und das Völkerecht*, Frankfurt am Main: Suhrkamp Verlag, 2000, f.68.

⁴⁶ Sylë Ukshini, “Ekspertët e së drejtës ndërkombëtare debatojnë rreth sulmeve të NATO-s kundër Serbisë”, *Rilindja*, Prishtinë, korrik 2000.

njerëzore dhe kombëtare të popujve të tjerë. Ata parapëlqejnë t'u referohen neneve dhe paragrafëve të KB-së, të cilat, sikundër dihet, janë të hartuara në periudhën e konfrontimeve Lindje-Perëndim dhe si të tilla ato kërkohet të riformulohen në dritën e zhvillimeve aktuale ndër-kombëtare, ashtu siç është e nevojshme edhe reformimi i vetë OKB-së.⁴⁷

Georg Nolte dhe ekspertë të tjerë, të cilët sulmet e NATO-s i konsiderojnë si të kundërligjshme, nuk e kontestojnë rëndësinë e madhe të të drejtave të njeriut. Por, pikërisht duke pasur parasysh mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ata argumentojnë se në marrëdhëniet ndërkombëtare s'duhet të tundet monopoli i pushtetit të Kombeve të Bashkuara. Në rast të kundërt, me pretekst të mbrojtjes së të drejtave të njeriut do të mund të ndodhnin shumë luftëra, çka në mënyrë të pashmangshme ka çuar në shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut dhe në krimet kundër njerëzimit.

Dhe, nëse Këshilli i Sigurimit qëndron në mosveprim - si në luftën e Kosovës - megjithëse ndëryrja do të ishte urgjente? Kjo dilemë, thotë Nolte, është e pazgjidhshme me kategori juridike. Ai këmbëngul se vetëmandatimi e cenon të drejtën ndërkombëtare. Ekziston mendimi se është moskuptim tradicional që e drejta ndërkombëtare të vendoset vetëm nga Këshilli i Sigurimit të KB-së. Sipas përkrahësve të intervenimit të NATO-s, karta e OKB-së, rezolutat e KS-së për Kosovën nga vjeshta e vitit 1998 dhe e drejta për ndihmë emergjente paraqesin një bazë të mjaftueshme dhe të qartë ligjore ndërkombëtare.⁴⁸

Argumentet kryesore, që e përlligjin ndëryrjen e NATO-s, janë si vijojnë:

- Ishte e nevojshme të realizohen parimet e së drejtës ndërkombëtare kundër bllokimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga shtetet, të cilat vetë nuk i respektojnë mjaft të drejtat e njeriut dhe demokracinë;⁴⁹

- Nëse Këshilli i Sigurimit nuk e realizon detyrimin e tij për intervenim, atëherë ekziston urtësia politike, që të veprojë edhe pa mandatin e tij, veç të tjerash duke u thirrur në ndihmën e parimit të pakontestueshëm juridik Nenit 51,⁵⁰

- Zhvillimi pozitiv i së drejtës ndërkombëtare përmes "ndëryrjes humanitare" mund të çojë në të ardhmen tek universalizimi i të drejtës

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ "Alle haben Skrupel", Interview mit Rudolf Scharping, *Der Spiegel*, 13/1999.

⁴⁹ S. Ukshini, "Eskpërtët e së drejtës ndërkombëtare debatojnë rreth sulmeve ...".

⁵⁰ Krh: Knut Ipsen, "Der Kosovo-Einsatz-Illegal? Gerechtfertigt? Entschuldbar?", në *Die Friedens-Warte*, Jg. 74, Nr. 1-2, Berlin: 1999, f. 22.

globale (të cilat rregullojnë luftën dhe paqen) dhe të politikave të të drejtave të njeriut, respektivisht të transformimit të së drejtës ndërkombëtare në të drejtë globale.⁵¹

- Zbulimi i planit strategjik të Milosheviqit për të “zgjidhur” problemin shqiptar, i njohur si operacioni “Patkoi”. Në përputhje me emrin e koduar të tij, Milosheviqi planifikonte t’i mbyllte shqiptarët brenda një patkoi gjigant dhe pastaj t’i detyronte ata të iknin nga Kosova.⁵²

Në anën tjetër, kritikët e sulmeve të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur, të paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, qëndrimet e tyre i mbështesin në këto pika:

- Rrezikimi i standardit të së drejtës ndërkombëtare të arritur pas vitit 1945 përmes vetëmandatimit;

- Rreziku, që përmes “intervenimit humanitar” të përdoren të drejtat e njeriut kundër parimeve në raportet ndërshtetërore.⁵⁴

Nga paraqitja e argumenteve pro dhe kundër mund të thuhet se çështja e intervenimit të NATO-s pa mandatin e Këshillit të Sigurimit kundër një shteti sovran, nuk është çështje që ka gjetur një interpretim të prerë dhe definitiv. Por, ekziston mendimi se në rast të bllokimit të Këshillit të Sigurimit, si në rastin e Kosovës që këtë e bëri veçanërisht Rusia dhe Kina, atëherë duhet të gjendet një formë tjetër alternative për autorizimin e një intervenimi të tillë, mbase përmes Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së sipas shembullit të vendimit “Uniting for Peace.”⁵⁵

Për më tepër, rasti i ish Jugosllavisë tregonte fare mirë potencialin dhe kufizimet e doktrinës së “ndërhyrjes humanitare”. Ajo duhej të ishte kryesisht një instrument për të ndaluar gjakderdhjen, për t’i nxitur palët për gjetjen e një kompromisi me anën e bisedimeve dhe kur masakrat ishin kryer, t’i nxirrte fajtorët para drejtësisë. Por, ajo është një instrument i vonuar, që nuk i ka të gjitha mjetet për të zgjidhur konfliktet e gjata shekullore.

⁵¹ Shih: Jürgen Habermas, “Bestialität. Ein Krieg an der Grenze zwischen Recht und Moral”, *Die Zeit*, nr.18, 29.04.1999, f.1.

⁵² J. G. Stoessinger, *Përse kombet shkojnë në luftë ...*, f. 183.

⁵⁴ Krh: Berthold Meyer, Peter Scholter, *Die Kosovo-Kriege 1998/1999. Die Internationale Intervention und ihre Folgen*. Hessische Stiftung Friedens-und Konfliktforschung (HSFK), Fankfurt 2000, f. 33.

⁵⁵ *Ibid*, f. 35.

Në këtë drejtim, mendohet se rrugëdalja do të mund të ishte autorizimi nga institucionet regjionale sipas Nenit 53 të Kartës së KB-së, nëse për këtë janë plotësuar kriteret e caktuara. Një rrugëdalje pragmatike nga kjo dilemë kishte dhënë edhe ish ministri i Jashtëm gjerman, Joscha Fisher, në fjalimin e tij në Asamblesë të Kombeve të Bashkuara më 22 shtator 1999, kur ai kërkonte futjen e një detyrimi për arsyetim para Asamblesë së Përgjithshme si “përparim substancial në rrugën e përdorimit të përgjegjshëm të vetos.”⁵⁶

Megjithatë, ky propozim dhe propozime të tjera nuk kanë shkuar më tutje, për shkak të rezistencës së shteteve që kanë të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Lidhur me rastin e intervenimit të NATO-s në Kosovë pa mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si në mesin e politikanëve ashtu edhe në vlerësimet e ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare, ekziston pajtueshmëri që ky rast nuk duhet të bëhet precedent. Por, vetëm kjo nuk mjafton, pasi me dispozitat e Kartës së OKB-së nuk është precizuar në mënyrë eksplicite çështja e intervenimit nga jashtë brenda një shteti që shkel të drejtat e njeriut. Kështu, derisa, neni 1 i Kartës precizon se “ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare” është ndër qëllimet kryesore të Kartës së Kombeve të Bashkuara, me nenet 39, 50, 51, 53 dhe 107 lejohen të ketë përjashtime. Por, sipas dispozitave të këtyre neneve, përdorimi i forcës lejohet po qe se këtë e bën Këshilli i Sigurimit.”

Në këndvështrimin e zhvillimeve të reja ndërkombëtare të fillimviteve 90-të, respektivisht prej ndryshimeve epokale në vitet 1989-1990 që çuan në shpërbërjen e Paktit të Varshavës dhe në dekompozimin e Bashkimit Sovjetik, si dhe të Jugosllavisë, është krijuar një realitet i ri në Evropë dhe në rrafshin e së drejtës ndërkombëtare, siguria evropiane ka fituar rëndësi të madhe si në aspektin praktik dhe atë teorik, ndërkaq çështja e intervenimit dhe e sovranitetit ka evoluar shumë. Në lidhje me këtë, eksperti për Ballkanin Stefan Trobest thotë: “Që prej përfundimit të bipolaritetit të politikës botërore sovraniteti shtetëror dhe integriteti i kufijve nuk janë më kategori të shenjta në rendin juridik ndërkombëtar, por mund të jenë të kufizuara për shkak të shkeljes sistematike të të

⁵⁶ Fjalimi i ministrit të Jashtëm të Gjermanisë, Joscha Fischer, para Asamblesë së 54 të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 22 shtator 1999 <http://www.auswaertiges-amt.de>

drejtave të njeriut.”⁵⁷ Ndërsa, Peter Shneider mbron mendimin se intervenimi ushtarak i NATO-s kundër shtypjes serbe në Kosovë ishte legjitim, madje i pashmangshëm.⁵⁸

Nga sa u trajtua më lart, del se, është e nevojshme të hartohen dhe të përcaktohen qartë parimet dhe mjetet për rastet e përdorimit të forcës nga jashtë. Në rast të shterimit të të gjitha mundësive politike dhe diplomatike që synojnë shmangien e vrasjeve masive dhe të katastrofës humanitare, do të duhej të bëhej i pamundur bllokimi i vendimmarrjes në Këshillin e Sigurimit, mbështetur në motivin se ky akt është në kundërshtim edhe me parimet e Kartës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Po kështu, pavarësisht nga qëndrimet formaliste të disa ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare dhe grupeve pacifiste dhe ultramajtiste në Perëndim, intervenimi ushtarak i NATO-s ishte legal, sepse edhe sipas së drejtës ndërkombëtare është e obligueshme të parandalosh gjenocidin dhe të zbrapsësh pasojat e spastrimit etnik, qoftë edhe me mjete ushtarake, kur asnjë alternativë tjetër nuk ka mbetur pa u shteruar.

Përmbledhje

Në rrethanat e krijuara pas Luftës së Ftohtë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare në veçanti, nuk konsiderohen më si një problem ekskluzivisht e brendshme për disa kohë, por si një çështje që kalojnë caqet e sovranitetit shtetëror dhe i japin të drejtën për të marrë kundërmasa bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare. Megjithatë, këto kundërmasa konsistojnë në përdorimin e forcës së armatosur me autorizimin e Këshillit të Sigurimit, gjë që në rastin e Kosovës mungoi për shkak të rolit bllokues të Ruisisë. Por, pas gjenocidit në Bosnjë, bashkësia ndërkombëtare nuk mund të qëndronte indiferente: e para, sepse tashmë kishte prova se qeveria e Milosheviqit synonte të realizonte planin e koduar “Patkoi”, sipas të cilit shumica e shqiptarëve të Kosovës do të dëboheshin në vendet fqinje për të krijuar më shumë “lebensraum” për pakicën serbe në Kosovë; e dyta, sepse ishte në pyetje kredibiliteti i NATO-s dhe siguria rajonale në

⁵⁷ Stefan Troebst, “Chronologie einer gescheiterten Prävention. Vom Konflikt zum Krieg im Kosovo, 1989-1999”, *Osteuropa*, nr. 8, Berlin: 1999, f. 794.

⁵⁸ Shih: Peter Schneider, “Die Menschenrechte brauchen verlässliche Fürsprecher”, në Frank Schirmacher, *Der westliche Kreuzzug. 41 Positionen zum Kosovo-Krieg*. Stuttgart: 1999, f. 228.

Evropën Juglindore. Në këtë kuptim, siç e thotë edhe gjenerali gjerman i NATO-s, Klaus Naumann, Kosova mund të jetë edhe një “mami” në zhvillimin e mëtutjeshëm të së drejtës ndërkombëtare, sepse një nga arsytet vendimtare që mbajti bashkë një koalicion prej nëntëmbëdhjetë shtetesh demokratike, të cilat ishin shumë të ndryshme në motivet e tyre, gjatë 78 ditëve të luftës, ishte bindja e përbashkët se në Kosovë po shkeleshin të drejtat elementare të njeriut dhe po kërcënohej një katastrofë humanitare. Nga analiza e mësipërme, del në pah se komuniteti ndërkombëtar nuk mund të qëndronte duarkryq përballë spastrimit etnik dhe krimeve të papara që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Sipas argumenteve të listuara, sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur, në parim, edhe pse ndodhnin pa një miratim të Këshillit të Sigurimit, ato ishin legjitime dhe të justifikueshme për faktin se Beogradi nuk kishte respektuar asnjë nga rezolutat paraprake të Këshillit të Sigurimit dhe as nuk kishte treguar vullnet për një zgjidhje paqësore në Konferencën e Paqes në Rambuje. Në kontekstin e ndryshimeve demokratike të pas Luftës së Ftohtë, shkelja masive e të drejtave të njeriut, respektivisht ushtrimi i dhunës dhe i terrorit nuk mund të trajtohet më si çështje e brendshme e një shteti, por problem i gjithë bashkësisë ndërkombëtare.

Duke e argumentuar vendimin e NATO-s për sulm kundër Jugosllavisë së mbetur, ministri i atëhershëm i Jashtëm gjerman, Joshka Fischer, në një intervistë për gazetën berlinase “Tageszeitung” konstaton: “Çfarë është dashur të bëjmë në mars të vitit 1999, kur Milosheviqi po e spastronte etnikisht Kosovën? T’i venim duart në gjoks dhe t’u thoshim shqiptarëve të Kosovës: na vjen keq, mirëpo ne nuk kemi vendim të Këshillit të Sigurimit. Në çfarë bote ne po jetojmë.”⁵⁹ Në këtë kontekst, ai, metodat brutale të politikës së Milosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës i krahasonte me doktrinën antishqiptare të Çubriloviqit.⁶⁰

⁵⁹ “Nuk ndihem fitimtar” (Tageszeitung: Intervistë me ministrin e Jashtëm gjerman, Joshka Fisher), botuar në *Rilindja*, botim në Perëndim, Zürich. 16.08.1999.

⁶⁰ “A ka doktrinë antishqiptare të fqinjët e përmendur më lart? Për fat të keq po, sidomos të serbët. Ajo s’është fantazi, është e shkruar, e formuluar qartë, e botuar, dhe kryesorja, e padënuar. Është doktrina e Çubriloviq, versioni i fundit, i një sërë programesh të ngjashme, e titulluar nga vetë autori “Dëbimi i shqiptarëve”. E ngjizur gati në të njëjtën kohë me projektin nazist për hebrenjtë dhe, për nga thelbi, jo larg atij. Ky draft famëkeq, i rënë tani në koma pret orët e saj. Bombat e NATO-s ndëshkuan Serbinë më 1999, por jo doktrinën.

“Politika e Milosheviqit që nga viti 1989, pothuajse deri në detaje ishte identike me pamfletin e nacionalistit radikal serb, Vasa Çubrilloviq, i cili u hartua në mars 1937 në Beograd”,⁶¹ konstaton Fisher.

Nëse shtetet evropiane kishin gabuar në Mynih më 1937 kur nuk e kishin ndalur Hitlerin, Evropa dhe ShBA nuk mund ta toleronin Milosheviqin më 1999 të destabilizonte krejt rajonin, me qëllim që të realizonte synimet e tij për Serbinë e Madhe. “Milosheviqi dukej se kishte harruar se Evropa nuk jetonte më në vitin 1937, porse kishte arritur në vitin 1999 dhe se bazohej në vlerat krejtësisht të tjera”,⁶² thotë Fischer.

Sidoqoftë, intervenimi i NATO-s në luftën e Kosovës nuk ishte i lehtë, dhe prej atëherë vazhdon të jetë pjesë e debateve shkencore të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare. Natyrisht, ky veprim i “njëanshëm” i NATO-s ishte i determinuar edhe për shkak të rrethanave që mbretëronin asokohe në Këshillin e Sigurimit, një organ i paralizuar, për shkak të qëndrimit të njohur bllokues rus. Për më tepër, ndërhyrja ajrore e NATO-s në luftën e Kosovës kishte një element të pakundërshtueshëm: sulmet, bombat e NATO-s nuk u provokuan nga ndonjë interes konkret i bashkësisë ndërkombëtare, por kishin një karakter tërësisht humanitar.

Pikërisht, ky argument, si dhe shterja e të gjitha përpjekjeve politike ndërkombëtare, e bënin të ligjshëm dhe të justifikueshëm intervenimin ajror të NATO-s kundër shtetit serb, madje, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së. Po ashtu, fushata ajrore e NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe konfirmoi se Aleanca Veriatlantike gjithnjë e më shumë po justifikonte veten si institucion qendror dhe i pazëvendësueshëm për garantimin e sigurisë euroatlantike. Mësimi tjetër nga rasti i intervenimit në Kosovë është se shkelja e të drejtave të njeriut kapërcen kornizat e sovranitetit shtetëror. Pra, rasti i Kosovës ishte një shtysë e madhe për zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës ndërkombëtare përmes ndërhyrjes

Thelbi i saj, siç tregon titulli i draftit: “Dëbimi i arnautëve”, trajton problemin fatal, sipas tij, të Serbisë: Serbia s’mund të ketë jetë normale, pa dëbimin e shqiptarëve, me të gjitha mënyrat dhe me çdo mjet: me ushtri, me kërcënim, me reformë agrare, me terror, me polici, me qen. Të gjitha përmenden një për një në këtë doktrinë”. Shih: Ismail Kadare, *Mbi krimin në Ballkan: letërkëmbim i zymtë*, Tiranë: Onufri, 2011, f. 90.

⁶¹ Joschka Fischer, *Die rot-grünen Jahre: Vom Kosovokrieg bis zum 11. September: Deutsche Außenpolitik - vom Kosovo bis zum Irak*. Verlag: Kiepenheuer & Witsch GmbH, 2007, f.181-182.

⁶² *Po aty*.

humanitare. Në këtë kontekst, aty ku ekziston një kërcënim për gjenocid, justifikimi për “punët e brendshme” nuk është i qëndrueshëm dhe nuk duhet të zbatohet. Pra, shteti i cili kryen krime masive: gjenocid, krime të luftës, spastrim etnik, krime kundër njerëzimit e humb të drejtën e qeverisjes me atë popullatë dhe, në raste të tilla, komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i përgatitur të ndër marrë veprime të duhura kolektive në ndëshkimin e shteteve agresore. Rrjedhimisht, pas mizorive të kryera në vitet 1990 në Ballkan dhe Ruandë, të cilat komuniteti ndërkombëtar nuk arriti t’i parandalojë, dhe ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë, e cila u kritikua nga shumë njerëz si shkelje e ndalimit të përdorimit të forcës, komuniteti ndërkombëtar u angazhua në një debat serioz se si të reagohej ndaj shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut. Në shtator 1999, ndërsa prezantoi raportin e tij vjetor në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Kofi Annan reflektoi mbi “perspektivat për sigurinë njerëzore dhe ndërhyrjen në shekullin e ardhshëm” dhe sfidoi shtetet anëtare që “të gjenin gjuhën e përbashkët në respektimin e parimeve të Kartës dhe veprimin në mbrojtje të përbashkët të njerëzimit”.

Sfida u mor nga Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror (ICISS), i krijuar nga qeveria kanadeze, e cila në fund të vitit 2001 nxori një raport të titulluar “Përgjegjësia për të mbrojtur”⁶³, sipas së cilës përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e popullit të tij i takonte para së gjithash vetë shtetit. Megjithatë, një “përgjegjësi e mbetur” qëndronte gjithashtu te komuniteti më i gjerë i shteteve, i cili “aktivizohet kur një shtet i caktuar nuk është qartësisht i gatshëm ose i paaftë të përmbushë përgjegjësinë e tij për të mbrojtur ose është vetë kryerësi aktual i krimeve ose mizorive”.⁶⁴

Pra, kur shtetet dështojnë për të mbrojtur popullsinë e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit, atëherë komuniteti ndërkombëtar, sipas rastit, duhet të inkurajojë dhe

⁶³ Koncepti i R2P u frymëzua nga ideja e Francis Deng “Sovraniteti i shtetit si përgjegjësi”. Sipas Deng, “Sovraniteti nuk është vetëm mbrojtje nga ndërhyrjet e jashtme, më tepër është një çështje e shteteve që kanë përgjegjësi pozitive për sigurinë dhe mirëqenien e popullatës së tyre. Për këtë arsye, përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e popullit të saj qëndron me vetë shtetin. R2P synon të mbrojtë popullsinë nga gjenocidi, krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe spastrim etnik”.

⁶⁴ The Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect supports two Special Advisers who report directly to the United Nations Secretary-General, <https://www.un.org/en/genocideprevention/office-mandate.shtml>

ndihmojë shtetet të ushtrojnë këtë përgjegjësi dhe të mbështesin Kombet e Bashkuara në krijimin e një aftësie paralajmërimi të hershëm. Kjo normë ndërkombëtare, e njohur si R2P - Përgjegjësia për Mbrojtjen – synon të sigurojë që bashkësia ndërkombëtare të mos dështojë më kurrë për të ndaluar këto krime.⁶⁵

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet pro dhe kundër, mund të vlerësojmë se ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur ishte legjitime, nëse marrim parasysh këta faktorë: mosrespektimi nga Beogradi i rezolutave të mëparshme të Këshillit të Sigurimit⁶⁶, të cilat i referoheshin Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; paralajmërimet nga bashkësia ndërkombëtare mbi rreziqet e një katastrofe humanitare në Kosovë; kërcënimi i paqes e i sigurisë në rajon dhe veçanërisht pamundësinë e miratimit të një rezolutë tjetër të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në një të ardhme të afërt, për shkak të qëndrimit bllokues të Ruisë e Kinës. Jürgen Habermas, filozof i njohur gjerman, mendon se për shkak të bllokimit të Këshillit të Sigurimit, NATO-ja mund t'i referohet në fakt vetëm vlefshmërisë morale të së drejtës ndërkombëtare - pra normave sipas të cilave nuk ekzistojnë instanca efektive zbatimi e afirmimi në kuadrin e bashkësisë ndërkombëtare.⁶⁷

Por, edhe pasi Serbia kishte vazhduar represionin mbi popullatën civile shqiptare dhe spastrimin etnik në Kosovë dhe për këtë arsye kishte ndodhur intervenimi ushtarak i NATO-s, çështja e statusit final për Kosovën kishte mbetur e hapur. Sidoqoftë, ky intervenim ushtarak i NATO-s kundër Beogradit i hapi shtegun qeverisjes së Kosovës në mënyrë të pavarur dhe jashtë juridiksionit të dhunshëm serb. Ndërsa, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, e cila duhet parë si një kompromis midis Perëndimit dhe Ruisë, nuk e përjashtonte në asnjë mënyrë ecjen e

⁶⁵ Mahfujur Rahman, Saifullah Akon, The Responsibility to Protect Doctrine: Expectations and Reality, International Journal of Trend in Scientific Research and Development (IJTSRD), Volume 4, Issue 3, April 2020.

<https://www.ijtsrd.com/papers/ijtsrd30314.pdf>

⁶⁶ Këshilli i Sigurimit të OKB-së gjatë vitit 1998 kishte miratuar tri rezoluta: 1160 (mars 1998), 1199 (shtator 1998) dhe 1203 (tetor 1998), përmes të cilave dënohej fushata represive dhe spastrimi etnik në Kosovë nga forcat serbe të sigurisë.

⁶⁷ Jürgen Habermas, "Ruajtësit e rendit", në *Lufta kundër luftës*, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 30.

Kosovës drejt pavarësisë, që shënonte njëkohësisht edhe kapitullin e fundit të shpërbërjes së Jugosllavisë.

S u m m a r y

NATO MILITARY INTERVENTION IN KOSOVO: A PRECEDENT CASE OR EXCLUSION?

In the aftermath of the Cold War, human rights violations and international humanitarian law were considered an international issue rather than simply as a domestic issue. This gave the international community and international organizations a basis to take action and intervene in cases where a state or an entity is either incapable or unwilling to protect its own people, or is actively persecuting them.

However, in the case of Kosovo, NATO intervention against Serbian on March 1999 targets took place with the prior authorization of the Security Council, due to the Russian threat to use its veto power. A year before, the Security Council had Adopted three Resolutions 1160 (March 1998), 1199 (September 1998) and 1203 (October 1998) through which it condemned the repressive campaign and ethnic cleansing in Kosovo by Serbian security forces.

Witnessing the Serb regime's grave violation of human rights and genocide in Bosnia in 1995, the international community had a strong reason to believe that the same would happen in Kosovo if a humanitarian intervention would not take place. This happened due to two main reasons: first, because the International Community had already gathered evidence that Milosevic's government started implementing the "horseshoe" operation, through which all ethnic Albanians from Kosovo would be displaced and moved out of their homes to neighboring countries and elsewhere, to create a "lebensraum" for the Serb minority in Kosovo and second, due to the fact that NATO's credibility and South Eastern Europe's security were at stake.

NATO's intervention in Kosovo is legitimate also because of these factors: Belgrade's direct violation of previous Security Council resolutions which referred to Chapter VII of the United Nations Charter; warnings from the International Community on the dangers of a humanitarian catastrophe in Kosovo; threatening of peace and security in the region and also because it was impossible to pass another resolution on the matter due to continuous veto and resistance from Russia and China at UNSC.

Another lesson drawn from the intervention in Kosovo is that where there is violation of human rights and such state is either incapable or unwilling to protect its own people, or is actually actively persecuting them, the domain of “domestic affairs” and “sovereignty” of one state over its domestic issues becomes irrelevant.

On this matter, Kosovo’s case opened the path for a new concept for humanitarian intervention in international law. Kosovo’s case pushed forward the development of the strategies in international law that would allow for future humanitarian interventions.

Consequently, in 2000, the Canadian government and several other actors announced the establishment of the International commission on Intervention and State Sovereignty (ICISS) to address the challenge of the international community’s responsibility to act in the face of the gravest of human rights violations while respecting the sovereignty of states. This doctrine aims at addressing four types of crimes; genocide, ethnic cleansing, war crimes and crimes against humanity. Therefore, in cases where there is threat for genocide, the justification that other parties can not interfere in domestic affairs of another country does not stand and should not be implemented.